



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0212

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE AS Tech SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe instalimi i pajisjeve të ftohjes dhe ngrohjes (inverter i kondicionerit)” me numër të prokurimit 661-25-5179-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA RANILLUG, më 12.05.2026, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e AS Tech SH.P.K., me nr. 2026/0212, e datës 03.04.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe instalimi i pajisjeve të ftohjes dhe ngrohjes (inverter i kondicionerit)”, me numër të prokurimit 661-25-5179-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA RANILLUG.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA RANILLUG për aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe instalimi i pajisjeve të ftohjes dhe ngrohjes (inverter i kondicionerit)”, me numër të prokurimit 661-25-5179-1-2-1.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.06.2025 KOMUNA RANILLUG, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe instalimi i pajisjeve të ftohjes dhe ngrohjes (inverter i kondicionerit)” me numër të prokurimit 661-25-5179-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontrats: **48,000.00 €**.

Me 17.03.2026 KOMUNA RANILLUG, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin e AK (B58), ku është anuluar aktiviteti

Me 23.03.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 24.03.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.04.2026, OEAS Tech SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoll 2026/0212, duke e atakuar Vendimin për anulim të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AS Tech SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Neni 6 LPP Neni 7 LPP Neni 59 LPP Neni 60 LPP Neni 62 LPP

3 Vendimet paraprake të OSHP-se për këto procedurë Parashtrime Ankesën lidhur me procedurën me titull “Blerja dhe instalimi i pajisjeve të ftohjes dhe ngrohjes (inverter i kondicionerit)”, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Parregullsitë dhe shkeljet e njëpasnjëshme të AK-së janë të shumta dhe serioze, dhe do të elaborohen si më poshtë.

Që nga iniciimi i këtij aktiviteti të prokurimit, është evidente se AK ka vepruar me tendencë të qartë për anulimin e procedurës, duke përdorur vazhdimisht arsyetime të ndryshme dhe të pabazuara në ligj. Historiku i kësaj procedure dëshmon qartë se pas çdo vendimi të saj të padrejtë, ne kemi ushtruar të drejtën tonë ligjore për ankesë në OSHP, dhe në çdo rast, OSHP ka vendosur në favor të ankesave tona, si vijon:

Ankesa nr. 2025/0668 – Pas hapjes së ofertave, në vend që të shpërblejë ofertën e kompanisë As Tech si ofertë më e lirë dhe e përgjegjshme, AK e anulon procedurën me pretendimin për gabime në specifikimet teknike. OSHP e vlerëson ankesën tonë si të bazuar dhe e kthen lëndën në rivlerësim.

Ankesa nr. 2025/1034 – Pas vendimit për rivlerësim, AK shpërblen me kontratë operatorin ekonomik Infinit, i cili ishte i papërgjegjshëm. Pas ankesës sonë, OSHP sërish vendos në favorin tonë dhe e kthen çështjen në rivlerësim.

Ankesa nr. 2025/1231 – AK përsërit të njëjtin veprim të kundërligjshëm duke shpërblyer përsëri OE Infinit, pa marrë parasysh vendimin paraprak të OSHP dhe ekspertizën e detajuar. Edhe në

këtë rast, OSHP e konsideron ankesën tonë të bazuar dhe e kthen lëndën në rivlerësim.

Nga këto vendime është më se e qartë se oferta që AK ka tentuar ta shpërblejë në mënyrë të përsëritur nuk është e përgjegjshme. Përballë këtij realiteti dhe mungesës së alternativave ligjore, AK është detyruar të procedojë drejt shpërblimit të ofertës sonë si e vetmja ofertë e përgjegjshme, duke kërkuar edhe vërtetimet për shpërblim të ofertës tone gjatë muajit shkurt 2026.

Megjithatë, pavarësisht se ne i kemi dorëzuar të gjitha vërtetimet në kohë dhe në përputhje me kërkesat, AK edhe kësaj here ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe të papranueshme, duke shpikur një arsyetim krejtësisht të ri për anulimin e procedurës.

Në vendimin e datës 17.03.2026, AK pretendon se për vitin 2026 nuk ka mjete të parapara për këtë projekt, dhe për këtë arsye duhet të anulohet procedura. Ky arsyetim përbën një shkelje flagrante të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Veprimet e njëpasnjëshme dhe tendencioze të AK-së, të orientuara qartazi kundër shpërblimit të ofertës së As Tech, përbëjnë shkelje të rënda të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe rregullave të KRPP-së, dhe janë të papranueshme për çdo zyrtar përgjegjës të prokurimit.

Arsyetimi për mungesë fondesh është i pabazë dhe joprofesional. Në asnjë rrethanë, disponueshmëria e mjeteve buxhetore nuk mund të përdoret si kriter për të vlerësuar përgjegjshmërinë e një oferte apo operatori ekonomik apo vete procedurës.

Inicimi i procedurës nënkupton domosdoshmërisht ekzistencën e një linje buxhetore. Dështimi i AK-së për të siguruar ose rikonfirmuar mjetet buxhetore është përgjegjësi ekskluzive e saj dhe nuk mund të përdoret për të penalizuar operatorët ekonomikë.

Mosparashikimi i buxhetit për këtë procedurë në vitin 2026, ndërkohë që procedura ka qenë aktive, është një veprim i papërgjegjshëm dhe potencialisht i qëllimshëm. Lejimi i praktikave të tilla krijon precedent të rrezikshëm, ku autoritetet kontraktuese mund të zvarrisin qëllimisht procedurat për të shmangur shpërblimin e ofertave të caktuara, duke mos i përfshirë më pas në planifikimet buxhetore.

Një qasje e tillë është e papranueshme, e kundërligjshme dhe hap rrugë për manipulime serioze në sistemin e prokurimit publik. Ne të ardhmen, duke i hapur rrugë AK të tjera të vepruonjë njesoj.

Edhe në rastin hipotetik se mungesa e buxhetit do të ishte reale, AK ka pasur mundësi të presë rishikimin buxhetor (zakonisht në muajt maj-qershor) ose të bëjë rialokim të mjeteve nga linja të tjera buxhetore, siç është praktikë e zakonshme në institucionet publike. Anulimi i menjëhershëm i procedurës nuk është as i domosdoshëm dhe as i arsyeshëm.

Gjithashtu, është plotësisht i pajustificueshëm referimi i AK-së në përgjigjet e Thesarit për mungesë fondesh. Thesari vetëm interpreton planifikimin buxhetor të paraqitur nga vetë AK, ndërsa përgjegjësia për vendimmarrje dhe menaxhim të financave publike mbetet ekskluzivisht tek AK si autoritet ekzekutiv.

Me këtë veprim, AK ka shkelur edhe nenin 59 të LPP-së, duke mos kryer vlerësim të drejtë dhe ligjor të ofertave dhe duke dalë jashtë kompetencave të saj. AK ka përdorur në mënyrë të paligjshme opinione nga institucione që nuk janë pjesë e procedurës së prokurimit (si Thesari),

duke i trajtuar ato si bazë për marrjen e një vendimi për anulim, gjë që është në kundërshtim të plotë me ligjin.

AK ka kryer gjithashtu shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 62 të LPP-së, i cili përcakton në mënyrë të qartë dhe taksative rastet kur një Autoritet Kontraktues mund të anulojë një procedurë të prokurimit. Në asnjë nga këto raste të parapara ligjërisht nuk mbështetet vendimi i AK-së për anulim.

Rrjedhimisht, vendimi për anulimin e procedurës është i pabazuar në ligj, arbitrar dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP-së, duke përbërë një tejkalim të qartë të kompetencave ligjore nga ana e AK-së.

Zvarritja e qëllimshme e procedurës, ankesat e njëpasnjëshme – të cilat kemi qenë të detyruar t'i paraqesim dhe që në çdo rast janë vlerësuar si të bazuara – si dhe zgjatja e vazhdueshme e sigurimit të tenderit për afro një vit, kanë shkaktuar kosto të konsiderueshme financiare dhe administrative për kompaninë tonë. Prandja anulimi i procedurës me vendim të njëanshëm të AK demton seriozisht kompaninë tonë në çdo aspekt.

Është thellësisht e padrejtë dhe e papranueshme që, pas gjithë këtij procesi të gjatë dhe të panevojshëm, si rezultat i gabimeve dhe veprimeve të kundërligjshme të vetë AK-së, të tentohet eliminimi i një oferte e cila në çdo fazë të procedurës ka qenë plotësisht e përgjegjshme që nga dita e hapjes së ofertave.

Një veprim i tillë jo vetëm që cenon parimet themelore të barazisë dhe trajtimit të drejtë në prokurimin publik, por gjithashtu përbën një dëm të drejtpërdrejtë dhe të pajustificueshëm ndaj operatorit ekonomik që ka vepruar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe procedurale.

Përgjegjësi dhe gabimet eventuale nëse janë të verteta të AK-së duhet të mbahet përgjegjësi nga vete ajo dhe asesi të kete pasoj në tere proceduren dhe në përgjegjshmerine dhe mundesine e shperblimit me kontrate të kompanise tone.

AK ka bërë shkelje të mëdha kur përveç vendimeve paraprake të OSHP-së që nuk i ka respektuar, edhe në vendimin e fundit pas të cilit u kthyer lenda në rivlerësim, bënë shkelje flagrante duke mos e respektuar aspak vendimin e OSHP-së.

Kërkojmë APROVIM të ankesës tonë si të BAZUAR, kthim të lëndës në rivlerësim dhe udhëzim për vazhdim të procedurës dhe rrjedhimisht shperblim të ofertes tonë me kontrate.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Komisioni i vlerësimit të ofertave, në konsultim me zyrtarin përgjegjës të prokurimit publik, filloi vlerësimin e ofertave më 12 mars 2026, bazuar në vendimin e OSHP-së nr. 2025/1231 të datës 3 shkurt 2026.

Gjatë vlerësimit të ofertës u vërtetua se oferta juaj ishte e përgjegjshme dhe tarifat u kërkuar, të cilat ju i dorëzuar brenda afatit ligjor. Megjithatë, duke pasur parasysh se fondet nga viti i kaluar hynë në tepriçë pasi nuk u përdorën gjatë vitit 2025 (fondet nga granti – fondi 10), më 25.02.2026 Drejtorit të Financave, ZKA-së dhe ZKF-së iu dërgua kërkesë për kthimin e këtyre fondeve.

Më 16 mars 2026 morëm përgjigje se nuk janë në gjendje të angazhojnë fondet për vazhdimin e procedurës së prokurimit publik në shumën prej 48,000.00 euro, të cilat ishin të destinuara për këtë projekt; sipas Ligjit 08/L-332 për ndarjet buxhetore dhe Ligjit 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, këto mjete po kthehen në buxhetin republikan. Pra, bazuar në këtë deklaratë të Drejtorit të Financave, nuk ka pasur qëllim të kërcënohet operatori ekonomik, por thjesht nuk ka fonde në dispozicion.

Bazuar në njoftimin e KRPP-së të datës 11 gusht 2025, të gjithë zyrtarët e prokurimit publik janë të obliguar të përdorin funksionin e burimit të financimit dhe të shkarkojnë të dhënat nga SIMFK duke përdorur numrin e kërkesës. Duke qenë se nuk kemi më fonde në dispozicion, nuk është e mundur të vazhdohet procedura e prokurimit publik apo të nënshkruhet kontratë me ndonjë operator ekonomik pa fonde aktive.

Sa i përket planit të prokurimit publik, plani vjetor hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të buxhetit. Duke qenë se kemi buxhet të kufizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe nuk mund të përfshihen të gjitha prioritetet për vitin 2026, plani është përgatitur në bashkëpunim me drejtorinë e Komunes së Ranillugut, ZKA-në dhe ZKF-në, duke përfshirë vetëm prioritetet e domosdoshme për vitin 2026; pra, nuk është bërë me qëllim anulimin e tenderit.

Përfundim: Kërkesa juaj për rishqyrtim është e pabazuar, pasi nuk kemi fonde në dispozicion.

Ju dërgojmë në bashkëngjitje të gjitha kërkesat përkatëse.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 10.04.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0212, ndërsa me datë 17.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0212, me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEAS Tech SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0212 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “**Blerja dhe instalimi i pajisjeve te ftohjes dhe ngrohjes (inverter i kondicionerit)**” me nr. të prokurimit: "661-25-5179-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA RANILLUG, procedurë e hapur, lloji i kontratës furnizim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, i cili me datë 17/03/2026 publikon njoftimin B58 mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se nuk posedojne më mjetet, për faktin se kanë qenë mjete nga fondi qeveritar, ndërsa OE ankues shpallet i pasuksesshëm.

Tutje OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK gjatë rivlerësimit të ofertave shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 6,7,59,60,62 dhe 3 vendime te PSH.

Tutje, OE ankues në ankesë pretendon se AK qëllimishtë ka neglizuar procesin e prokurimit, ne menyrë që mos të shpallemi ne fitues, fondet janë kthyer, mirëpo AK mund të kërkoj rialokim të mjeteve nga linjat tjera, dhe gjithashtu është dashur që të planifikohet buxheti paraprakishtë duke qenë se aktiviteti i prokurimit ka qenë në proces të rivlerësimit, ose te bëhet rialokim i mjeteve, mirëpo AK qëllimishtë ka neglizhuar procedurën deri në tërheqje të fondeve nga Qeveria.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:

Ekspertja shqytuese pas analizmit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, aktiviteti i prokurimit si procedure ka filluar me hapjen e ofertave me datë **23/06/2026**, i cili aktivitet është rivlerësuar tri herë, sipas vendimeve të panelit shqyrtues me numrat: 205/0668; 2025/1034; 2025/1231, dhe rrjedhimisht ne vendimin e fundit 2025/1231 AK shpalle të përgjegjshëm OE ankuesin, mirëpo pas kërkesës për verifikim të mjeteve, i njëjti anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se fondet kanë qenë të qeverisë dhe se janë kthyer si tepricë në buxhet të Kosovës. Pra, si e tillë prolongimi i aktivitetit të prokurimit nga AK, ka rezultuar me humbje të fondeve nga qeveria, dhe se duke qenë se deklarata e nevojave të disponueshmërisë së fondeve, përkatësisht **NENI III** nuk është shqyrtuar dhe nënshkruar për publikim të vendimit mbi rekomandimin e operatorit ekonomik, dhe si e tillë meqenëse Rregullorja për Prokurim Publik, neni 8, par. 8.5 obligon personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDF që para publikimit të formularit B58 “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar, ekspertja shqytuese konsideron se vazhdimi i këtij aktivitet të prokurimit në mungesë të fondeve mund të qoj në një shkelje të ligjit ashtu siç parashihet në nenin 62.1 pika 1.1 të LPP-së. Andaj, konsideroj se AK ka zbatuar drejt dispozitat ligjore në lidhje me anulimin e kësaj procedure për shkak se neni 62.1 pika 1.1 e ligjit për Prokurim Publik, parasheh:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Sa i përket ankesës së OE ankues, ekspertja shqytuese konsideron se duke pasur parasysh shpenzimet e ofertimit të cilat krijohen për OE, sikurse sigurimi i tenderit dhe tarifa e ankesës, ankesa duhet ti aprovohet pjesërisht e bazuar OE ankues për shkak se anulimi i procedurës është bërë për shkak të mungesës së fondeve dhe jo të OE ankues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi njoftimi për anulim të aktivitetit të Autoritetit Kontraktues KOMUNA RANILLUG.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA RANILLUG**
- **OE - AS Tech SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: